



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



STATUTI
I
QENDRËS KULTURORE TË FËMIJËVE TË PRISHTINËS

Prishtinë

Në bazë të dispozitave të nenit 15 të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 33, pika 33.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 27.01.2011, miratoi

STATUTIN E QENDRËS KULTURORE TË FËMIJËVE TË PRISHTINËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Më këtë Statut rregullohet statusi juridik i Qendrës Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: "*Qendra*"), veprimtaria, organizimi, përfaqësimi, planifikimi dhe transparenca.

Neni 2

Për realizimin e të drejtave dhe përgjegjësiqe që i takojnë, Qendra vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për institucionet kulturore, këtë Statut dhe vendimet të cilat i miraton Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

II. STATUSI JURIDIK I QENDRËS

Neni 3

Qendra është themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01 - 28518, të dt. 18.11.1961.

Neni 4

Në pajtim me Vendimin për rithemelimin e Qendrës 01. nr. 031 -485, të dt. 3.10.2006, Qendra ka vazhduar punën - veprimtarinë e Qendrës, themeluar sipas dispozitave të nenit 3 të këtij Statuti.

Neni 5

Selia e Qendrës është në Prishtinë, Pallati i Rinisë.

Neni 6

6.1 Emërtimi i Qendrës është: "*Qendra Kulturore e Fëmijëve të Komunës së Prishtinës*".

6.2 Qendra ka status të personit juridik, me të drejta dhe përgjegjësi që i takojnë me ligj, Statut dhe vendime të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

6.3 Pasuria e Qendrës është pronë e Komunës.

6.4 Qendra për qarkullim financiar përdor xhirollogarinë e Komunës dhe nënlllogarinë e caktuar nga Komuna.

6.5 Në ballinën hyrëse të objektit ku ushtron veprimtarinë Qendra vendoset mbishkrimi në gjuhët zyrtare, paraparë sipas Ligjit për përdorim të gjuhëve.

Neni 7

7.1 Qendra ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore;

7.2 Vula e rrumbullakët është me diametër 2.5 cm dhe ka këtë përmbajtje:

- Rrethi i parë: *Republika e Kosovës*;
- Rrethi i dytë: *Komuna e Prishtinës*;
- Rrethi i tretë: *Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës*;
- Në mes të vulës është *emblema - logoja e Komunës*.

7.3 Vula katrore e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë 6 x 2.5 cm, me përmbajtje:

- *Republika e Kosovës*;
- *Komuna e Prishtinës*;
- *Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës*;
- *Njësia organizative, numri dhe data*.

III. VEPRIMTARIA E QENDRËS

Neni 8

Në kuadër të Qendrës kryhen këto veprimtari:

- a) Pranimi dhe angazhimi i fëmijëve të grup-moshave prej 6 - 16 vjeç, në bazë të vullnetit dhe vullnetit të prindërve, afinitetit dhe talentit për edukim dhe argëtim të tyre;
- b) Prezantimi i solistëve, instrumentistëve, koreve dhe ansamblit të valleve nga ana e Sektorit të muzikës;
- c) Paraqitja e recitimeve nga ana e grupit letrar, hartimi i teknikave të pikturimit, duke pasur për bazë grup-moshat e fëmijëve;
- d) Përgatitja e fëmijëve për realizim e ekspozitave nga artet figurative;
- e) Përgatitja e fëmijëve për vallëzim modern, ritmik dhe të baletit;
- f) Kryerja e punëve tjera të parapara me ligj;
- g) Puna e ambasadorëve të vegjël.

IV ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Neni 9

9.1 Qendra veprimtarinë e saj e realizon përmes njësive organizative: Sektorit të muzikës, Grupit të dramës, Grupit letrar dhe Grupit ritmik të vajzave, Ansamblit të këngëve dhe valleve, Sektorit të Sportit dhe Klubit të ambasadorëve të vegjël.

9.2 Qendra ka edhe Sektorin e punëve të përbashkëta.

9.3. Qendra, në bashkëpunim me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, mund të themelojë edhe njësi të tjera, sipas kërkesave, mundësive buxhetore dhe kritereve të përcaktuara me ligj.

9.4. Me aktin për organizim të brendshëm, Qendra do të rregullojë organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive veç e veç.

V. ORGANET E QENDRËS

Neni 10

Organet e Qendrës janë:

- a) Drejtori,
- b) Këshilli i Qendrës dhe
- c) Kolegjiumi profesional.

Neni 11

Drejtor i Qendrës emërohet personi, i cili, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të ketë edhe përgatitje superiore dhe së paku 3 vjet përvojë pune në lëmin e kulturës dhe arsimit.

Neni 12

12.1 Drejtori i Qendrës, në procedurë të konkursit publik, në bazë të propozimit të Komisionit për konkurs dhe mendimit të drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, emërohet me Vendim të Kryetarit të Komunës, në pajtim me dispozitat e ligjit për marrëdhënie pune që vlejnë për institucionet publike.

12.2 Në kushte dhe procedurë të caktuar ligjore, mund të shkarkohet edhe para periudhës për të cilën është emëruar.

Drejtori i qendrës

Neni 13

Drejtori i Qendrës:

- a) Organizon, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Qendrës;
- b) Propozon politikat e zhvillimit të Qendrës dhe politikat për mbështetje financiare;

- c) Organizon, mbikëqyr dhe motivon punën e personelit dhe jep udhëzime dhe urdhëresa për punë;
- d) Paraqet raportet përkatëse për rezultatet e punës, ecurinë e shërbimeve dhe përdorimin e buxhetit përmes DKRS, Kuvendit të Komunës;
- e) Përcjell problematikën e Qendrës dhe merr masa për zgjidhje me të mira;
- f) Ushtron edhe detyra e autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me aktin e emërimit, dispozitat ligjore dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me Qendrën.

Neni 14

14.1 Drejtori i Qendrës e cakton Këshillin e Qendrës, me përbërje 5 anëtarësh, nga radhët e punonjësve me detyra udhëheqëse e profesionale në Qendër, si dhe nga radhët e veprimtarëve të kulturës, të arsimit dhe të shkencës jashtë këtij institucioni.

14.2 Në Këshillin e Qendrës përfshihen edhe anëtarë nga radhët e grup-moshës 8 - 16 vjeç.

14.3 Këshilli i Qendrës:

- a) Jep këshilla, mendime dhe sugjerime për organizimin, veprimtarinë dhe shërbimet e Qendrës;
- b) Mbron vlerat e Qendrës dhe çështjet tjera profesionale në përputhje me ligj, Ligjin për institucionet e kulturës, Statutin dhe aktet tjera;
- c) Shqyrton planin dhe programin e punës;
- d) Propozon ndryshimet në Statut dhe ndryshimet në aktet tjera.

Neni 15

15.1 Kolegjiumi profesional përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët emërohen nga drejtori.

15.2 Kolegjiumi profesional përbëhet nga anëtarët e njërive të Qendrës. Kolegjiumi profesional, si organ profesional këshilldhënës i drejtorit të Qendrës:

- a) Jep mendime profesionale lidhur me organizimin e punës dhe kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së Qendrës;
- b) Shqyrton raportet dhe programet vjetore të punës së Qendrës;
- c) Jep propozime për aftësimin profesional të punonjësve;
- d) Bashkëvepron në përpilimin e punimeve profesionale të cilat i boton Qendra;

VI. PËRFAQËSIMI

Neni 16

Qendrën e prezanton drejtori i saj. Në pamundësi të kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të saj, atë mund ta zëvendësojë personi, të cilin e cakton drejtori i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i cili në këtë rast ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e drejtorit.

VII. FINANCIMI I QENDRËS

Neni 17

Mjetet financiare për kryerjen e veprimtarisë, Qendra i siguron nga:

- a) buxheti i Komunës;
- b) të ardhurat nga donacionet, fondacionet, OJQ - të e themeluara në Kosovë dhe jashtë saj, shërbimet me pagesë, të cilat do të shfrytëzohen për pasurimin e koleksionit për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Qendrës dhe
- c) burimet tjera të parapara me ligj dhe akte të tjera nënligjore.

VIII. PLANI DHE RAPORTI I PUNËS

Neni 18

Drejtori i Qendrës harton planin e punës dhe raporton për punën e bërë. Plani i punës dhe raporti i punës, për çdo vit, miratohet nga Drejtoria e Kulturës rinis dhe Sportit.

Neni 19

Drejtori i Qendrës harton planin e punës në pajtim me qëllimet për të cilin është themeluar Qendra.

IX. NJOFTIMI I PUNONJËSVE, TRANSPARENCA DHE SEKRETI ZYRTAR

Njoftimi i punonjësve

Neni 20

Njoftimi i punonjësve bëhet:

- a) Përmes publikimit të vendimeve të marra në tabelën e shpalljeve të Qendrës;
- b) Në bazë të kërkesës së secilit punonjës, në mënyrë që t'i jepen shënimet e kërkuara lidhur me realizimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tij.

Transparenca dhe sekret i zyrtar

Neni 21

21.1 Puna e Qendrës është transparente për publikun.

21.2 Transparenca për punën e Qendrës realizohet përmes:

- a) Organizimit të ekspozitave për prezantim;
- b) Bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat në lëmin e shkencës, të arsimit, të kulturës dhe
- c) Ueb - faqes.

Neni 22

Drejtori i Qendrës është i autorizuar që të japë njoftim me shkrim dhe njoftim përmes shtypit, radios dhe TV - së për çështjet që kanë të bëjnë me punën e Qendrës.

Neni 23

Sekret zyrtar në Qendër është dokumentacioni dhe shënimet, transparenca e të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e Qendrës dhe Komunës në përgjithësi. Sekret zyrtar do të trajtohet dokumentacioni dhe shënimet, të cilat janë paraparë me vendim të veçantë të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

X. MBROJTJA DHE TË DREJTAT E PUNONJËSVE

Neni 24

24.1 Për realizimin e të drejtave të punonjësve, ata mund t'i drejtohen drejtorit të Qendrës dhe drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

24.2 Ndaj Vendimit të marrë nga drejtorët mund të ushtrohet ankesë pranë Komisionit të ankesave të Komunës së Prishtinës.

XI. AKTET E QENDRËS

Neni 25

25.1 Në bazë të Statutit të miratuar nga Kuvendi i Komunës, Qendra, përmes Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit miraton rregullore dhe vendime, me të cilat më saktësisht rregullohet veprimtaria e Qendrës dhe të drejtat e punonjësve të këtij institucioni.

25.2 Aktet e cekura në pikën 1 të këtij neni, duhet të nxirren në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes së këtij Statuti në fuqi.

25.3 Aktet e miratuara publikohen në tabelën e shpalljeve të Qendrës.

XI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Nga dita kur hyn në fuqi ky Statut, pushojnë të vlejnë statutet dhe ndryshimet e tyre të miratuara para hyrjes në fuqi të këtij Statuti.

Neni 27

Ky Statut hyn në fuqi 8 ditë pas miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.nr. 110 - 155, më 27.1.2011

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS

Sami Hamiti, e.d.c. i dipl.

